

NEVERIA E SARTRE-IT SI KONCEPT ABSURD PËR JETËN

Dëfrim SALIU

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Frënge

defrim.saliu@unite.edu.mk

Avdi VISOKA

Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina“, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Frënge

avdi.visoka@uni-pr.edu

UDC 821.133.1-312.1.09

Review

Abstract

In the works of Jean-Paul Sartre we encounter a junction of existentialism as a philosophical stream and literary stream. It cannot be taken as coincidence this binomial. A large number of existentialists, especially French ones, were at the same time novelists, playwrights, publicists, and in some cases poets. The circumstances of Sartre's life influenced him to deal in parallel with philosophy and literature. *Nausea* was a true lesson of the time. In this novel is the life of the 1930s, which for Sartre was the beginning or the reasons for writing this novel. *Nausea* keeps track of this experience, as in the structure of a story that resembles a novel in creation or many reasons that this tale depicts hero Antoine Roquentin in the position of an original writer.

This novel in his make-up staged a lonely, exiled person in a seaside town resembling Le Havre. Of course, Antoine Roquentin has no professional obligation, a position as a philosophy professor, and will pass to Mathieu, a future character in the *Roads of Freedom*. So Sartre's first novel, which gives a good example of sequencing the text in succession, later on this text reaches many readers meanings. Approaches to this novel have been added periodically, starting with the philosophical summaries of psychoanalytic studies, text analysis for genesis studies.

Key words: *Nausea, Sartre, French, existentialism, absurd.*

Përmbledhje

Në veprat e Jean-Paul Sartre-it hasim një kryqëzim të ekzistencializmit si rrymë filozofike dhe rrymë letrare. Nuk mund të merret si rastësi ky binom. Një numër i madh i ekzistencialistëve, veçanërisht i atyre francezë, në të njëjtën kohë kanë qenë romancierë, dramaturgë, publicistë dhe në disa raste edhe poetë. Rrethanat e jetës së Sartre-it ndikuan që ai të merret paralelisht me filozofi dhe letërsi. *Neveria* ishte një mësim i vërtetë i kohës. Në këtë roman paraqitet jeta e viteve '30 të shekullit XX, që për Sartre-in ishin fillimi apo arsyet e shkrimit të këtij romani. *Neveria* i mban gjurmët e kësaj përvoje, si në strukturën e një historie që ripërsërit një roman në krijim apo shumë arsye që ky tregim e paraqet heroin Antoine Roquentin-in në pozitën e një shkrimtari fillestar.

Ky roman në sajimin e tij vë në skenë një njeri të vetmuar, të mërguar në një qytet bregdetar që ngjan me Le Havre. Sigurisht Antoine Roquentin-i nuk ka asnjë detyrim profesional, pozita si një profesor filozofie, do ta kalojë edhe te Mathieu, personazh i ardhshëm te *Rrugët e lirisë*. Pra, romani i parë i Sartrit i cili jep shembull të mirë të renditjes së tekstit në mënyrë të njëpasnjëshme, më vonë ky tekst arrin kuptime të shumta nga ana e lexuesit. Qasjet për këtë roman janë shtuar në mënyrë periodike, duke filluar nga përmbledhjet filozofike të studimeve psikoanalitike, të analizës së tekstit për studimet e gjenezës.

Fjalët kyçe: *Neveria, Sartre, frënge, ekzistencializmi, absurdi.*

Hyrje

Një libër nuk është vetëm një grumbull i vogël i gjetheve të thata, apo një formë e madhe në lëvizje: leximi. Leximi është induksion, ndërfitje, jashtëfitje dhe baza e këtyre aktiviteteve qëndron në vullnetin e autorit, siç është besuar për një kohë të gjatë ashtu siç mbështetet induksioni shkencor në vullnetin hyjnor. Një forcë e ëmbël që na shoqëron dhe na mban nga fillimi në fund.

Leximi pra është një pakt bujarie ndërmjet autorit dhe lexuesit: secili i beson tjetrit, mbështetet te tjetri dhe kërkon po aq sa edhe te vetvetja. Sepse në vetvete ky besim është bujari: asgjë nuk mund ta detyrojë autorin të besojë se lexuesi përdor lirinë e tij, asgjë nuk

mund ta detyrojë lexuesin të besojë se autori ka përdorur të tijën.¹ Me këto fjalë në vitin 1939 Sartri i përgjigjet akuzave të François Mauriac-ut.

Në veprën *Çështë letërsia* (sic) në të cilën mundohet të sqaroj se receptimi i veprës letrare është i rëndësishëm për konstituimin dhe kuptimin e saj. Çka e bën të mbijetueshëm romanin *Neveria* kur e dimë që kanë kaluar gati 80 vjet nga publikimi i tij. Pra, romani i parë i Sartrit i cili jep shembull të mirë të renditjes së tekstit në mënyrë të njëpasnjëshme, më vonë ky tekst arrin kuptime të shumta nga ana e lexuesit.² Qasjet për këtë roman janë shtuar në mënyrë periodike, duke filluar nga përmbledhjet filozofike të studimeve psikoanalitike, të analizës së tekstit për studimet e gjenezës.

Një vëllim i këtillë nuk do të mjaftonte për të dhënë një përshkrim të detajuar të hapave të mëvonshëm të një vepre e cila mund të kuptohej lehtë nga lexuesit. Sot sipas shumë kritikëve letrarë *Neveria* meriton më shumë vëmendje. Në vitet e fundit, një masë e madhe e dokumenteve ndihmojnë që të njohim më mirë gjenezën e këtij romani, duke filluar nga dorëshkrimi i fundit i veprës, botime të ndryshme të shtypura dhe një libër i pazëvendësueshëm për lexuesit botuar në vitin 1981 nga shtëpia botuese Gallimard në koleksionin La Pléiade.

***Neveria* si koncept absurd për jetën**

Sartre-i ishte bartës i ideve të mëdha politike të kohës së tij, ai njihej si një liridashës dhe intensivisht i pranishëm në tërë botën. I njohur për kulturën e tij të madhe dhe një shije të qartë që fshin kufijtë jo vetëm në mes të disiplinave, por edhe kontinenteve, ndërmjet popujve dhe klasave. Sartre-i paraqet idenë se kur dikush ballafaqohet me absurdin duhet të vazhdojë jetën, këtë ide ai mundohet ta shpjegojë nëpërmjet romanit të tij *Neveria*.

Romani është i shkruar në formë ditari, i shkruar në vetën e parë, ku personazhi kryesor është një 30 vjeçar me emrin Antoine Roquentin. Ai pas disa viteve udhëtimi nëpër botë, kthehet në Francë dhe zgjedh një qytet francez me port detar të ngjashëm me Le Havre, që është Bouville për të përfunduar hulumtimin për jetën e një figure politike të shekullit të XVIII, siç ishte markezi Adhémar de Rolleston.³

Gjatë dimrit të vitit 1932 e kaplon një sëmundje e ëmbël *neveria* siç e quan ai, gjithnjë e cila i cënon pothuajse çdo gjë që ai gëzon si: projektin e tij kërkimor, mikun e tij Autodidaktin

¹ Zhan-Pol Sartri, *Çështë letërsia*, DeaS, Tiranë, 1998, fq. 42.

² Jacques Deguy, 'La nausée' de Jean-Paul Sartre, Gallimard, Paris, 1993, fq. 11.

³ Zhan-Pol Sartri, *Neveria*, Fan Noli, Tiranë, 2014, fq. 18.

i cili kishte lexuar të gjitha librat në bibliotekën lokale sipas rendit alfabetik, kujtimet e tij për Anny-n, një vajzë angleze të cilin ai dikur e donte, duart e saj dhe bukurinë natyrore.

Antoine Roquentin protagonist i romanit ishte një ish-aventurier i cili ka jetuar në Bouville për tre vjet. Antoine Roquentin nuk mban kontakte me familjen dhe nuk kishte shumë miq. Ishte një njeri i vetmuar dhe shpesh i pëlqente të dëgjojë bisedat e të tjerëve dhe të shqyrtojë veprimet e tyre. Edhe pse me kohë e pranon që duke u përpjekur për të gjetur një lloj ngushëllimi pranë të tjerëve, ai gjithashtu ekspozon shenja të mërziqjes dhe mungesës së interesit, kur bashkëvepron me njerëzit.

Sipas tregimit të Autodidaktit një ditë, para shtatë vitesh (më ka thënë se ka shtatë vjetë që studion) ka hyrë me zulmë në këtë sallë. Ka përshkruar me vështrim librat e panumërta ndër mure dhe ka thënë me vete, pak a shumë si Rastinjaku: „O shkenca humane, do t’ju mund“. Pastaj ka shkuar e ka marrë librin e parë në raftin e parë në fund djathtas, e ka hapur te faqja e parë, me një ndjenjë respekti përzier me frikë, shoqëruar me vendosmëri të patundur.⁴

Anny është një vajzë angleze e cila dikur ka qenë e dashura e Antoine Roquentin-it, pas takimit të fundit në Bouville me të, Anny e bën të qartë se ajo ka ndryshuar shumë dhe duhet të vazhdojë jetën e saj. Antoine Roquentin-i kthehet në të kaluarën, duke shpresuar se ajo mund të dëshirojë të ripërcaktojë marrëdhëniet e tyre, por ai është refuzuar përfundimisht prej saj. Nga pikëpamja psikologjike Antoine Roquentin-i mund të shihet si një individ që vuan nga depresioni, një nga simptomat e gjendjes së tij.

Si një i papunë, ai jeton në kushte të privuari, ku i mungon kontakti njerëzor, duke u bllokuar në fantazitë e markezit Adhémar de Rollebon të shekullit të XVIII, ku mundohet që të zbulojë fshehtësitë e tij duke shkruar librin për të. Sipas shkrimeve që i gjenë për Adhémar de Rollebon-in ai ishte fort i shëmtuar. Mbretëresha Marie Antoinette e thërriste *majmuni im i dashur*. Megjithatë, ai i shtynte në dorë të gjitha gratë e oborrit, jo duke u tallur me to, siç sillej rëndom bufoni Voisenan, por me një lloj magjie që ua ngrinte peshë zemrat bukurosheve e që i shtynte në pasionet më të liga.

Prandaj dhe jam këtu, për hir të këtij zotërie. Kur u ktheva nga udhëtimet, mundesha fare mirë të jetoja në Paris apo në Marseille. Por, shumica e dokumenteve që lidhen me periudhat e jetës së markezit në Francë ndodhen në bibliotekën bashkiake të Bouville-ës.⁵

⁴ Zhan-Pol Satri, *Neveria*, Fan Noli, Tiranë, 2014, fq. 61.

⁵ Ibid., fq. 29.

Problemi i Antoine Roquentin-it nuk është thjesht depresioni apo sëmundjet mendore, edhe pse përvoja e tij e ka shtyrë atë deri në këtë gjendje.

Atëherë kur neveria e pushton, ai shkrehet e bie mbi stol, nuk e din ku ndodhej, sheh ngjyra që rrotullohen ngadalë përreth tij dhe i vjen për të vjellë. Dhe ja, prej atij çasti, neveria nuk më ka lëshuar, ajo më zotëron.⁶ Sartri paraqet vështirësitë e Antoine Roquentin-it që dalin nga gjendja e natyrshme e njeriut ekzistencial. Rrethanat e tij janë në dukje të veçantë, ato shkojnë përtej treguesve të thjeshtë nga depresioni i tij i vërtetë, të cilat janë menduar për të nxitur tek ai dhe lexuesit një gjendje më të hapur për të vënë re një situatë ekzistenciale, por mund të mos jenë të ndjeshëm.

Antoine Roquentin-i i nënshtrohet një përvoje të çuditshme metafizike që e largon atë nga bota. Problemet e tij nuk janë thjesht një rezultat i çmendurisë personale, pa rëndësi të madhe, por është viktimë e forcave më të mëdha ideologjike, sociale dhe ekzistenciale që kanë sjellë ata në prag të çmendurisë. Këto probleme të cilat e brengosin Antoine Roquentin-in që mund të quhet si *shikim i tjetrit* (le regard d'autrui), marrëdhëniet e të cilit me rrethin dhe ambientin mbylleen në negativitetin e përshkruar si neveri.

Neveria na jep disa nga imazhet më të dobishme të njeriut në atë kohë dhe kjo është funksioni më i lartë i artit. Me kalimin e kohës, neveria vepron mbi ekzistencën dhe e detyron atë të urrej veten marrëzisht. Pika kulminante në këtë vepër është komentimi mbi reagimin tonë universal ndaj problemeve të përbashkëta të jashtme. Ai zhvesh teorinë e Sartre-it për ankthin e ekzistencializmit dhe i shqetësuar kërkon kuptim për të gjitha gjërat që e kanë përmbushur jetën e tij deri në atë pikë.

Dhe më në fund Antoine Roquentin-i zbulon natyrën e të qenit, ku ai përballlet me një përkohëshmëri të limituar të vetë ekzistencializmit. Në fund të romanit ai e pranon indiferencën e botës imagjinare ndaj qëllimeve njerëzore dhe është i aftë të shikoj atë jo vetëm si një keqardhje, por edhe si një mungesë ku njerëzit janë të lirë për të dhënë mendimin e tyre, pra kjo liri ka një përgjegjësi për të zotuar ndërgjegjen. Ky ditar filozofik e shtyn atë të zbulojë se cilësia kryesore e gjërave është pasiguria.

Papritmas, neveria e tij merr një kuptim metafizik nga e cila e tërë ekzistenca është tepër absurde. Fjala *absurditet* sapo lind nga pena ime, pak më parë, në kopsht, nuk e gjeta dot, por as e kërkova, nuk më duhej, mendoja pa fjalë, mbi gjërat, *me gjërat*. Absurditeti nuk ishte një ide në kokën time, as një pipëtimë zëri, por ai gjarpër i gjatë i ngordhur te këmbët e mija, ai

⁶ Zhan-Pol Sartri, *Neveria*, Fan Noli, Tiranë, 2014, fq. 41.

gjarpër prej druri.⁷ Sipas kritikëve letrarë Sartre-i shpesh është në mes tensioneve midis filozofisë dhe politikës në njërën anë, kundrejt romaneve dhe individit nga ana tjetër.

Ideja e Sartre-it është liria, në mënyrë specifike ai kërkon që qenia për veten të jetë një qenie për vetveten dhe jo për të tjerët, një qenie për të tjerët ndodh kur njerëzit e pranojnë moralin të futur nga të tjerët, një qenie në vetvete thotë, ai ndodh kur njerëzit nuk do të heqin dorë nga objektet e natyrës.⁸ Liria nuk është aftësia për të bërë fizikisht çfarëdo që dëshiron, është aftësia për t'ia interpretuar mendërisht dikujt jetën e vet për veten, për të përcaktuar vetveten dhe për të krijuar vlerat e dikujt.

Neveria si ndjenjë dhe ankth, si një akt tragjik para botës së pajustificueshme dhe vetvetes poashtu, neveria si vetëdije e të qenurit të njeriut si objekt, si pasqyrim i përsiatjeve të tij mbi marrëdhëniet me botën, si përvojë e ndjenjës së tij të një ekzistence të paarsyeshme, e cila nuk është ndonjë fenomen apo dukuri mashtruese, as temë e re që për të parën herë e hasim te Sartre-i. Me talentin e vet, padyshim të rrallë e paraqiti dhe e shtroi në një formë më të fuqishme dhe më pak të durueshme për të gjitha shtresat.

Por, si temë gjendet edhe te bashkëkohësit e madje edhe te paraardhësit të tij qofshin ata ateistë apo krishterë. Ndërsa lufta po i kanosej njerëzimit, Sartre-i botoi romanin *Neveria* dhe pastaj me përmbledhjen e novelave *Muri*, me të cilat vërtet nuk depërtoi në masat e gjëra, por talenti i tij ra në sy të qarqeve letrare. Por, ajo që e shkruan në këto vepra në lidhje me problemin e lirisë do të ballafaqohet me realitetin, pas kthimit nga Gjermania ku kishte qenë rob lufte.

E meqë shkrimtari beson se i ka thyer lidhjet që e lidhin atë me klasën nga e cila rrjedh, meqë ai u flet lexuesve nga lartë për natyrën njerëzore universale, i duket se thirrja që i lëshon dhe pjesa që merr nga të këqijat e tyre janë diktuar nga bujaria e pastër. Të shkruash d.m.th. të japësh.⁹ Vetëm në një shoqëri të tillë shkrimtari mund të vë re se nuk ka asnjë dallim të asnjë lloji mes subjektit dhe publikut të tij. Sepse subjekti i letërsisë ka qenë gjithnjë njeriu dhe bota.

Për aq kohë sa publiku virtual do të qëndrojë në një det të errët rreth një plazhi të vogël të publikut real, shkrimtari do të rrezikojë të ngatërrojë interesat dhe kujdesin e njeriut me atë të një grupi të vogël të favorizuar.¹⁰ Temat metafizike që Sartre-i i paraqet në veprat e tij

⁷ Ibid., fq. 237.

⁸ Zhan-Pol Sartri, *Çështje letërsia*, DeaS, Tiranë, 1998, fq. 77.

⁹ Ibid., fq. 82.

¹⁰ Ibid., fq. 119.

përs shkruajnë ndjenjat se çdo gjë bëhet absurde në dritën e vdekjes, njerëzit të ndjehen të lirë derisa ato të ekzistojnë dhe se ky është një vizion ekzistencialist.

Duke denoncuar besimin e keq të atyre që kërkojnë të arsyetojnë ekzistencën e tyre nga vlerat e sigurisë dhe mosbesimit të humanizmit aq sa ai mendon gjendjen universale dhe jo gjendjen e njeriut, ku më në fund mundësia për të shpëtuar njeriun nga paqartësitë vjen përmes artit dhe letërsisë. Pikënisja e absurdit në krijimtarinë letrare të Sartre-it shfaqet në përmbledhjen me tregime të shkurtra. Vëllimi i cili do të bëhet një ndër veprat më të njohura të Sartre-it është *Muri*, që botohet në vitin 1937, e shkruar para aktivizimit të tij në politikë.

Në këtë vepër Sartre-i rrëfen ngjarjen që ndodh gjatë Luftës Civile Spanjolle, në të cilën ai ndihet i pashpresë me rritjen e forcave fashiste në Spanjë. Vdekja është një nga temat më të rëndësishme në këtë vepër. Kur dikush është i dënuar me vdekje, ai e shikon jetën në një mënyrë krejtësisht tjetër. Njerëzit që dikur kishin menduar aq shumë për lirinë, tash nuk kanë më rëndësi, gjithashtu Pablo Ibbieta arrin në përfundim se vdekja nuk është e natyrshme. Njerëzit e udhëheqin jetën e tyre nën supozimin se do të vazhdojnë të jetojnë siç ata thonë, njerëzit e kanë iluzionin e të qenit të përjetshëm.¹¹

Pablo Ibbieta paraqet ndërgjegjësimin e njeriut i cili është zhgënjyer nga jeta e tij, për shkak të dënimit të tij me vdekje, ai reflekton mbi jetën e tij dhe gjen absurditetin e saj. Për Sartre-in njeriu është i përcaktuar vetëm nga veprimet e tij dhe duhet të marrë përgjegjësi për të. Ai tregon historinë e një të burgosuri i cili ka hequr dorë nga jeta para se të vritet. Apo përcakton gjendjen e vështirë të tre burrave që janë marrë të burgosur pa paralajmërim ose shpjegim nga forcat falangiste,¹² të cilët veprojnë sipas urdhrave të gjeneralit Franco.

Historia rrëfhet nga Pablo Ibbieta, një aktivist i dikurshëm politik i cili e konsideron veten si më të ditur në krahasim me dy të tjerët, pa dyshim me qëllim të mirë. Pas marrjes në pyetje shkurtimisht, të tre të burgosurit janë dënuar me vdekje me pushkatim. Ata do të përballen me fatin e tyre. Pablo Ibbieta e gjen veten gjithnjë e më të shqetësuar nga reagimet e të burgosurve të tjerë, duke i krahasuar sjelljen e tyre ndaj tij. Tom Steinbock është i dënuar i dytë i cili e nervozonte shumë Ibbietën, për arsye se fliste shumë.

Shoku i tretë, një djalë i quajtur Juan Mirbal, i cili në mënyrë të përsëritur proteston për pafajësinë e tij, duke pretenduar se falangistët e kanë gabuar atë. Pablo-s i ofrohet një mënyrë

¹¹ Zhan-Pol Sartër, *Muri*, Koha ditore, Prishtinë, 2005, fq. 25.

¹² Falangistët janë parti e djathtë ekstreme spanjolle që u vu në shërbim të gjeneralit Franko.

për të dalë nga burgu, nëse ai e zbulon vendndodhjen e shokut të tij.¹³ Gjatë tërë natës ata e parafytyrojnë ekzekutimin e tyre, që do të bëhet të nesermën në agim.

Të tre burrat reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjekut belg, cilin e kishin dërguar për t'i ngushëlluar dhe për të regjistruar sjelljen e tyre para ekzekutimit të dënimit. Pablo Ibbieta e respektonte mjekun, mirëpo mjeku nuk ndikohet nga të burgosurit. Pablo Ibbieta pranon të bashkëpunojë pak para ekzekutimit të tij dhe ai u tregon falangistëve se ku gjendet Ramon Gris. U tregon se është te varrezat duke menduar që t'i mashtrojë dhe ta provoj fatin të fitoj kohë. Oficeri i forcave falangiste bashkë me pesëmbëdhjetë ushtarë nisen për te varrezat, atje e takojnë Ramon Gris-në.

Ata kthehen pas gjysme orë, oficeri i urdhëron ushtarët që t'a lirojnë Pablo Ibbieta dhe pas luftës do të vendosë një gjyq i rregullt për fatin e Pablo Ibbieta-ës.¹⁴ Kështu që Ramon Gris-i vritet ndërsa jeta e Pablo Ibbieta-s është të paktën përkohësisht larg nga vdekja. Por, në mbrëmje i sjellin disa të burgosur të rinj dhe një ndër ta është bukëpjekësi Garcia. Ai i tregon se e kanë kapur Ramon Gris-në sot në mëngjes te varrezat, sepse ishte fjalosur me kushëririn dhe që të mos i bëj askujt probleme kishte thënë: „Do kisha vajtur tek Ibbieta për t'u strehuar, po meqë e kanë kapur, po vete të fshihem në varreza“.¹⁵

Përfundimi

Në vitet e fundit të jetës Sartre-i ka sqaruar fillimet e tij në letërsi. Në intervista të ndryshme në të cilat ka shpreh reflektimet e tij për të kaluarën, por të publikuara pas vdekjes së tij, që i gjejmë këto sqarime në ditaret dhe korrespondencat e tij. Kjo vepër solli në dritë një raport të ngushtë dhe kontradiktor që dikush mendon se ekziston midis autorit dhe Antoine Roquentin-it, se është personazhi i tij.

Me kthimin e subjektit në letërsi dhe ripërtëritjen e autobiografisë (një ringjallje të kësaj gjinie nga Sartre-i dhe suksesi i tij me *Fjalët*) ai paraqet një aktualitet saqë kritikët nuk do të dyshojnë në të. Deri në botimin e romanit *Neveria* në pranverën e 1938 (libri del në shitje në prill) të rrallë ishin ata, ndër ta edhe lexuesit e parë, të cilët e njihnin emrin e Sartre-it. Edhe të rrallë ishin ata të cilët kishin dijeni se çfarë peripecish ka kaluar hartimi, redaktimi, ashtu edhe publikimi përfundimtar i këtij romani.

¹³ Zhan-Pol Sartër, *Muri*, Koha ditore, Prishtinë, 2005, fq. 28.

¹⁴ Zhan-Pol Sartër, *Muri*, Koha ditore, Prishtinë, 2005, fq. 31.

¹⁵ Ibid., fq. 32.

Në kohën kur e boton këtë roman Sartre-i ishte 33 vjeçar, kjo moshë e cila mund të merret si produktive për paralajmërimin e një gjeniu të parakohshëm. Për dallim nga shkrimtarët e tjerë mund të themi se Sartre-i në krahasim me të tjerët, fillon pak më vonë publikimin e veprave të mirëfillta letrare.

Romani nuk do të marrë ndonjë çmim letrar, që është një mundësi e humbur për të tërhequr vëmendjen e një publiku më të gjerë. *Neveria* nuk ishte një best-seller i menjëhershëm, me një tirazh prej 7000 kopjesh të shitura para luftës, ku shitja e kopjeve deri në vitin 1950 do të kaloj mbi 50000 kopje. Por, për të arritur famën e saj shtëpia botuese Gallimard duke filluar nga viti 1956 do ta botoj në edicionin *Le livre de poche*, të koleksionit *Folio* deri në vitin 1972, që deri më sot të përkthehet në 19 gjuhë të huaja.

Bibliografia

- SARTRE, Jean-Paul (1972). *La Nausée*, Paris: Gallimard.
- SARTRE, Jean-Paul (1972). *Le Mur*, Gallimard, Paris: Gallimard.
- SARTRE, Jean-Paul (1970). *Qu'est-ce que la littérature?*, Paris: Gallimard.
- SARTRE, Jean-Paul (2014). *Neveria*, Tiranë: Fan Noli.
- SARTËR, Zhan-Pol (2005). *Muri*, Prishtinë: Koha ditore.
- SARTRI, Zhan-Pol (1998). *Çështë letërsia*, Tiranë: DeaS.
- AYER, Alfred Jules (1945). *Jean-Paul Sartre*, London: Horizon.
- BERISHA, Beqir (2016). *Filozofimi midis logjikës dhe absurdit*, Tetovë: Çabej.
- DEGUY, Jacques (1993). *'La nausée' de Jean-Paul Sartre*, Paris: Gallimard.
- GERASSI, John (1992). *Sartre, conscience haïe de son siècle*, Monaco: Rocher.
- IDT, Geneviève (1971). *La Nausée, analyse critique*, Paris: Hatier.
- KAUFMANN, Walter (2011). *Ekzistencializmi nga Dostojevski te Sartri*, Tiranë: Plejad.
- LECARME, Jacques (1973). *Les critiques de notre temps et Sartre*, Paris: Garnier.
- LÉVY, Bernard-Henri (2000). *Le Siècle de Sartre*, Paris: Grasset.
- MOUNIER, Emmanuel (1953). *Malraux, Camus, Sartre, Bernanos - L'espoir des désespérés*, Paris: Seuil.
- SINANI, Mirela (2016). *Pikëpamjet ekzistencialiste të Zh. P. Sartrit në novelat e tij 'Muri'*, Tiranë.
- VISOKA, Avdi (2011). *Koha e shkrimit*, Prishtinë: 99-AIKD.
- VISOKA, Avdi (2016). *Shkrim dhe receptim*, Prishtinë: Faik Konica.